

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI FILLOR



PUNIM DIPLOME

Ermirë IDRIZI

Mitrovicë, 2019

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI FILLOR



PUNIM DIPLOME

**NDIKIMI I TRAJNIMEVE NË ZBATIMIN E
KURRIKULËS SË RE TE MËSIMDHËNËSIT E
ARSIMIT FILLOR NË QYTETIN E VUSHTRRISË**

Mentori/ja:
Prof. Ass. Dr. Merita SHALA

Kandidati/ja:
Ermirë IDRIZI

Mitrovicë, 2019

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI FILLOR



PUNIM DIPLOME

Lënda: Bazat e hulumtimit në edukim

Titulli i punimit: Ndikimi i Trajnimeve në Zbatimin e Kurrikulës së Re të Mësimdhënësive e Arsimit Fillor në Qytetin e Vushtrrisë

Emri dhe mbiemri: Ermirë Idrizi

Statusi i studentit: I rregullt

Numri i amzës (ID Regjistri): 1506011077

Niveli i studimit: Bachelor

Programi i studimit: Fillor

Mentorja e punimit: Prof. Ass. Dr. Merita Shala

Aprovuar nga komisioni:

1. /Emri Mbiemri, Titulli/ _____, mentor

2. /Emri Mbiemri, Titulli/ _____, anëtar

3. /Emri Mbiemri, Titulli/ _____, anëtar

Data e aprovimit: _____

DEKLARATË

Deklaroj, se të gjitha fjalitë dhe idetë e cituara dhe perifrazuara në këtë punim, marrë nga autorët e tjerë, janë përdorur sipas rregullave akademike të shkrimit, në mënyrë specifike nga referenca të qarta për autorin, sipas stilit APA¹. Unë jam e vetëdijshme se çdo shmangie e rregullave të shkrimit akademik duke mos i përdorur referencat, përbën plagjiaturë.

Emri dhe mbiemri: Ermirë IDRIZI

Nënshkrimi:



Data: Dhjetor, 2019

¹ APA- American Psychological Association

DEDIKIM

Versioni final elektronik i këtij punimi, i dedikohet shërbimit të studentëve të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, në harmoni me nenin 9&10 të Rregullores për Hartimin e Punimit të Diplomës së nivelit Bachelor.

Emri: Ermirë IDRIZI

Nënshkrimi:



Data: Dhjetor, 2019

FALENDERIMET

Përgjatë katër viteve të studimeve në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", në Fakultetin e Edukimit, Programi Fillor, fitova njohuri të thella në fushën e edukimit dhe mësimdhënies, duke u përgatitur kështu si gjenerata e re për tu përballur me sfida të kohës në profesionin e mësimdhënies. Ajo që vlen të theksohet përgjatë këtyre viteve të studimeve, është vullneti dhe dëshira ime për tu përgatitur për një profesion kaq human, sfidues, e me shumë të panjohura për mua dhe secilin nga kolegët e mi që pretendojnë të përballen me edukimin e gjeneratave që vijnë.

Ambienti i studimeve në Fakultetin e Edukimit të Universitetit "Isa Boletini", ishte mjaft i përshtatshëm, ndërsa kuadri akademik i përgatitur dhe i gatshëm për të debatuar tema në fushën tonë të studimeve. Me këtë rast, dua të shprehë falënderimin tim për të gjithë personelin akademik të cilët me dijen dhe angazhimin e tyre, lehtësuan jo vetëm mbarimin me sukses të studimeve, por edhe përgatitjen time si mësimdhënëse e ardhshme. Një falënderim të veçantë dua t'i shprehë mentores sime Prof. Ass. Dr. Merita Shalës, e cila në asnjë rast nuk hezitoi të më mbështesë gjatë punimit të kësaj teme hulumtuese dhe mjaft sfiduese.

Praktika profesionale të cilën e mbajta në dy shkolla fillore të qytetit të Vushtrrisë (Ali Kelmendi dhe Naim Frashëri), ishte përvoja ime më e mirë dhe sfiduese për tu njoftuar me profesionin, ku përballë kisha nxënësit e klasës së parë (pesë javë praktikë në vitin e dytë të studimeve), dhe nxënësit e klasave të pesta (gjashtë javë praktikë gjatë vitit të tretë dhe tetë javë gjatë vitit të katërt të studimeve). Me këtë rast, shpreh respektin tim të thellë për vogëlushët e këtyre klasave, ndërsa falënderimin tim të thellë për mësueset mentore, Ganimete Ademi dhe Sanie Spahiu, të cilat patën gatishmëri në çdo moment për të bashkëpunuar dhe mentoruar punën time, si dhe mësuesen mentore, nënën time të dashur Mevlyde Idrizi-n, e cila ishte jo vetëm lehtësuese dhe mentore në përgatitjen time si mësuese, por së bashku me babanë tim Ferit Idrizi-n, si dy veteranë dhe kontribuues së arsimit shqip që nga vitet e 90-ta, ishin edhe frymëzuesit e mi kryesorë për fillimin e karrierës sime për të studiuar në fushën e edukimit.

ABSTRAKT

Zbatimi i Kurrikulës së Re mbetet një ndër detyrat kryesore të mësimit të mesimdhënësve që kërkon përgatitje profesionale adekuate, shkathhtësi metodike, pedagogjike, si dhe njohuri të thella të përmbajtjes së Kurrikulës së Re. Për më tepër, zbatimi i Kurrikulës së Re kërkon edhe trajnime profesionale, në harmoni me fushat kurrikulare dhe kompetencat e të nxënësve. Kjo në vete përbën edhe një transformim të metodologjisë për të gjithë mësimit të mesimdhënësve, në veçanti për mësimit të mesimdhënësve me përvojë të gjatë në arsim të cilët si gjatë studimeve, ashtu edhe në karrierën e tyre arsimore, kanë zbatuar një metodologji të mësimit të mesimdhënësve e cila dallon shumë nga ajo që kërkohet në zbatimin e Kurrikulës së Re. Andaj, trajnimi i mësimit të mesimdhënësve nga institucione të akredituara, si dhe programe të harmonizuara me Kurrikulën e Re, ndihmojnë shumë në përgatitjen e tyre për tu përballur me sfidat e reja të kohës bashkëkohore të mësimit të mesimdhënësve.

Qëllimi i këtij punimi ishte që të nxjerrë në sipërfaqe të gjeturat dhe mangësitë në zbatimin e Kurrikulës së Re, duke përfshirë ndikimin e trajnimeve në përgatitjen e mësimit të mesimdhënësve për zbatimin e kësaj kurrikule. Hulumtimi ka qasje kuantitative (sasiore), ndërsa pjesëmarrësit e tij janë mësimit të mesimdhënësve të arsimit fillor, karakteristikë e të cilëve është trajnimi i tyre për zbatim të Kurrikulës së Re. Popullata është përzgjedhur përmes mostrës së qëllimshme në të cilën gjithsej morën pjesë 41 mësimit të mesimdhënësve nga shkollat fillore të qytetit të Vushtrrisë, ndërsa si instrument për mbledhjen e të dhënave është përdorur pyetësori, të dhëna të cilat janë analizuar përmes programit SPSS. Rezultatet e dalta nga ky hulumtim, treguan se sfidat kryesore që pengonin zbatimin e Kurrikulës së Re ishin: ngarkesa e madhe me punë administrative, numri i madh i nxënësve në klasa, mungesa e materialeve didaktike etj. Kurse sa i përket pajtueshmërisë se sa ishin të kënaqur me programet e ofruara nga trajnimet për zbatim të Kurrikulës, 78.0% (32) e mësimit të mesimdhënësve ishin mesatarisht të kënaqur, ndërkohë një pjesë e vogël prej 17.1% (7), ishin plotësisht të kënaqur me këto programe. Gjithashtu, pjesa më e madhe e mësimit të mesimdhënësve prej 63.45% (26) u shprehën se janë mesatarisht të kënaqur me nivelin e përgatitjes së trajnerëve. Të pyetur se sa ishin optimist ndaj suksesit të Kurrikulës, vetëm 17.1% (shtatë) mësimit të mesimdhënësve shprehën qëndrim pozitiv.

Lista e fjalëve kyçe: Kurrikula e Re, zhvillimi profesional, mësimit të mesimdhënësve, zbatimi, sfidat.

TABELA E PËRMBATJES

DEKLARATË	V
DEDIKIM	VI
FALENDERIMET	VII
ABSTRAKT.....	VIII
LISTA E FIGURAVE.....	X
LISTA E TABELAVE.....	XI
1. HYRJJE.....	1
1.1 Analiza e gjendjes.....	2
1.2 Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve.....	3
1.3 Sfidat e Reformës në Arsim.....	4
1.4 Reformat në Arsim dhe Rezistenca për Ndryshime.....	5
2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	7
2.1 Hipotezat	7
2.2 Pjesëmarrësit	8
2.3 Instrumentet	9
2.4 Mënyra e mbledhjes së të dhënave	9
2.5 Analiza e të dhënave.....	10
2.6 Aspekti etik	10
3. REZULTATET	11
3.1 Zbatimi i Kurrikulës së Re	11
3.2 Zhvillimi i Kapaciteteve të Mësimdhënësve	25
4. DISKUTIMET DHE KONKLuzionET	35
LISTA E REFERENCave	38
SHTOJCË.....	40

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Kualifikimet e mësimdhënësve	4
Figura 2. Metodatat dhe instrumentet e vlerësimit	33
Figura 3. Vlerësimi me feedback i mësimdhënësve	34

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Të Dhënat Përshkruese për Gjininë e Pjesëmarrësve.....	8
Tabela 2. Të Dhënat Përshkruese për Nivelin e Arsimit të Mësimdhënësve.....	9
Tabela 3. Rezultatet e Hulumtimit për Gjini, Nivel Arsimit dhe Moshë, lidhur me Përshtatshmërinë e KKK-së, Kompetencat e të Nxënësve, si dhe Arritshmëria e Kompetencave për Shkallë I	12
Tabela 4. Rezultatet e Hulumtimit për Gjini, Nivel Arsimit dhe Moshë, lidhur me Arritshmërinë e Kompetencave për Shkallë II, Përfshirjen e Lëndëve në Fushat Kurrikulare, si dhe Harmonizimin e Planeve Ditore dhe Vjetore	14
Tabela 5. Rezultatet e Hulumtimit për Gjini, Nivel Arsimit dhe Moshë, lidhur me Harmonizimin e Planeve Ditore dhe Detyrime, Informimin e Nxënësve me Ndryshimet Kurrikulare si dhe Prezantimin e Projekteve të Nxënësve.....	16
Tabela 6. Rezultatet e Hulumtimit për Gjini, Nivel Arsimit dhe Moshë, lidhur me Informimin e Nxënësve me Kriteret, Format dhe Periudhat e Vlerësimit	18
Tabela 7. Rezultatet e Hulumtimit për Gjini, Nivel Arsimit dhe Moshë, lidhur me Informimin e Nxënësve me Vlerësimin e tyre, të Prindërve me Ndryshimet Kurrikulare, si dhe Pjesëmarrjen e Prindërve në Hartimin e KKK-së me Bazë në Shkollë.....	20
Tabela 8. Rezultatet e Hulumtimit për Gjini, Nivel Arsimit dhe Moshë, lidhur me Informimin e Prindërve me Format dhe Vlerësimin e Nxënësve	21
Tabela 9. Rezultatet e Hulumtimit mbi Suksesin e Zbatimit të KKK-së.....	22
Tabela 10. Rezultatet e Hulumtimit mbi Sfidat e Zbatimit të KKK-së	23
Tabela 11. Rezultatet e Hulumtimit që nxjerrin Rekomandimet e Mësimdhënësve rreth Zbatimit të KKK-së	24
Tabela 12. Rezultatet e Hulumtimit për Gjini, Nivel Arsimit dhe Moshë, lidhur me Trajnimet e Mësimdhënësve për Zbatim të KKK-së, Programet Trajnuese, si dhe Nivelin e Përgatitjes së Trajnerëve	26
Tabela 13. Rezultatet e Hulumtimit për Gjini, Nivel Arsimit dhe Moshë, lidhur me Zbatimin e Planit Ditor, Bashkëpunimin e mësimdhënësve, si dhe Ndihmën e Koordinatorit të Cilësisë.....	28
Tabela 14. Rezultatet e Hulumtimit për Gjini, Nivel Arsimit dhe Moshë, mbi Gatishmërinë e Mësimdhënësve për Zbatim të KKK-së, zbatimin të PIA-s, Specifikimit të Materialeve dhe Burimeve gjatë Planifikimit Dymujor	30
Tabela 15. Rezultatet e Hulumtimit për Gjini, Nivel Arsimit dhe Moshë, mbi Punën Administrative të Planifikimit, Planifikimeve në bazë të Udhëzuesve, Ndikimit të Trajnimeve në Ngritjen e Kapaciteteve të Mësimdhënësve.....	32

1. HYRJE

Ngritja e cilësisë në arsim dhe mësimi i mirë, janë të lidhura ngushtë me cilësinë e mësimdhënies dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, andaj ato nuk ndodhin rastësisht. Në botën moderne të një arsimimi të standardizuar, qasja ndaj zhvillimit profesional të mësimdhënësve është prioritet i politikave arsimore si një proces i vazhdueshëm. Zhvillimin profesional të mësimdhënësve duhet vlerësuar si një ndër faktorët kryesorë, i cili ndikon drejtë për së drejti në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve si vazhdimësi që fillon gjatë kohës së shërbimit, vazhdon në vitet e para të fazës fillestare të mësimdhënësve të kualifikuar dhe përfshin një zhvillim gjatë karrierës së tyre të mësimdhënies. Mësimdhënësit finlandezë punojnë në kontekste që sigurojnë autonomi dhe agjenci të lartë profesionale në punën e tyre, edukimi i tyre para shërbimit i përgatit për këtë rol të përgjegjshëm (Niemi, 2015). Në anën tjetër, megjithëse kishte përpjekje të vazhdueshme të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e cila kishte nisur me hartimin e koncepteve fillestare nga viti 2004-2005, për të vazhduar më pas me licencimin e mësimdhënësve me licenca të karrierës, pagesa sipas kualifikimit të mësimdhënësve, themelimin e Këshillit Shtetëror për Licencim në vitin 2009, dhe deri te hartimi i Kornizës Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve të vitit 2017 në Kosovë, që kishte për qëllim zhvillimin profesional të mësimdhënësve në karrierë, përcaktimin e standardeve të profesionit të mësimdhënësit përgjatë karrierës, prapë se prapë zhvillimi profesional i mësimdhënësve, ende mbetet sfidë dhe detyrë e institucioneve arsimore për të arritur standardet e dëshiruara (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2017). Duke i hulumtuar sfidat dhe vështirësitë në sistemin arsimor në Kosovë, në veçanti cilësinë në arsimin fillor që është e lidhur me një varg faktorësh, e në veçanti me zhvillimin profesional të mësimdhënësve, ky hulumtim është ndarë në katër kapituj që trajtojnë çështje të veçanta që lidhen me zhvillimin profesional të mësimdhënësve, e që kanë për qëllim zbatimin e Kurrikulës së Re. Kapitulli i parë analizon gjendjen e sistemit të arsimit fillor në Kosovë, duke u bazuar në të dhëna të dokumenteve strategjike dhe legjislativë, sjell fakte dhe krahasime nga rishikimi i literaturës e cila kryesisht është përdorur nga publikimet shkencore; kapitulli i dytë trajton metodologjinë e hulumtimit duke përfshirë: hipotezat, pjesëmarrësit në hulumtim, instrumentin e përdorur, mënyrën e mbledhjes dhe analizën e të dhënave mbi bazën e të cilëve është zhvilluar hulumtimi; kapitulli i tretë sjell rezultatet nga analiza e të dhënave përmes

programit SPSS, kurse në kapitullin e katërt përfshihen diskutimet dhe konkluzionet rreth temës dhe rezultateve të dala.

1.1 Analiza e gjendjes

Që nga paslufta, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është duke u përballur me sfida të shumta të reformimit të sistemit arsimor në Kosovë, me qëllim të ofrimit të një arsimit cilësor dhe të standardizuar për të gjitha nivelet e arsimit, duke filluar nga ai parashkollor e deri te arsimit i lartë. Në kuadër të këtyre përpjekjeve, parashihej ndarja e fondeve të veçanta për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve me qëllim të zhvillimit të aftësive të mësimitdhënies, ndërsa shërbimet e trajnimeve të siguroheshin përmes një procesi të konkurrencës së hapur ndërmjet institucioneve të autorizuara për trajnimin e mësimitdhënësve. Po ashtu, parashihej edhe themelimi i qendrave për mësimitdhënie cilësore në universitete, duke përfshirë hartimin e programeve individuale për zhvillim profesional për çdo mësimitdhënës (MASHT, 2004). Edhe pse këto objektiva ishin premtuese, raportet e mëvonshme treguan se shumë nga to nuk arritën të realizohen. Andaj, ngritja e cilësisë së mësimitdhënies mbeti edhe më tej një sfidë për Ministrinë e Arsimit. Në anën tjetër, strategjia e arsimit kishte përcaktuar tregues optimist përmes së cilëve deri në vitin 2010, të gjithë mësimitdhënësit do të aftësoheshin për punë me kompjuterë dhe me aplikacionet themelore të TI-së², si dhe të ofroheshin programe funksionale që mundësojnë rikualifikim të mësimitdhënësve në shërbim. Deri në vitin 2015, institucionet e arsimit të lartë do të ofronin programe cilësore për përgatitjen e mësimitdhënësve në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare. Kurse deri në vitin 2017, të gjithë mësimitdhënësit në shërbim do të përfshiheshin në programe të akredituara për zhvillim profesional, si dhe të posedonin të paktën një licencë (Këshilli i Ekspertëve për Arsimin Parauniversitar, 2007). Edhe analizat e bëra gjatë hartimit të strategjisë për sigurimin e cilësisë, kishin nxjerrë në sipërfaqe se njëra ndër sfidat në Arsimin Parauniversitar të Kosovës, është mungesa e mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet. Përderisa Inspektorati i Arsimit ka të drejtë të merret me çështjet administrative dhe komnat mbajnë përgjegjësi formale për sigurimin e cilësisë, në realitet ekziston një konfuzion mbi ndarjen e përgjegjësiave mes autoriteteve qendrore dhe lokale. Kjo shpesh shkakton perceptime të ndryshme të Inspektoratit të Arsimit dhe DKA-ve³ në rolet e tyre përkatëse që kanë të bëjnë me

² TI- Teknologji Informative.

³ DKA- Drejtoria Komunale e Arsimit.

sigurimin e cilësisë. Një pjesë të përgjegjësisë për sigurimin e cilësisë e ka edhe niveli shkollor, mekanizmat e së cilit janë jo-ekzistues apo jo-funksionalë. Bazuar në këto të gjetura, si sfida kryesore të mekanizmit të sigurimit të cilësisë kishin dalë:

1. Ndarja e përgjegjësive ndërmjet nivelit qendror dhe komunal;
2. Licencimi i mësimitdhënësve;
3. Vlerësimi me bazë në shkollë;
4. Mekanizmat jofunksional të sigurimit të cilësisë në nivel shkollor;
5. Integriteti i mekanizmave të sigurimit të cilësisë (MASHT, 2016).

Me qëllim të ngritjes së cilësisë, në shumë dokumente strategjike, prioritet kishte zhvillimi profesional i mësimitdhënësve. Licencimi i mësimitdhënësve ishte menduar si një nga mekanizmat kryesorë për zhvillimin e cilësisë së mësimitdhënies, motivimin e mësimitdhënësve për performancë të mirë, si dhe për adresimin e rasteve kur performanca nuk është në nivelin e duhur. Sistemi i licencimit të mësimitdhënësve, ashtu siç është planifikuar të zbatohet, ngërthen në vete mekanizmin e zhvillimit profesional të obliguar për secilin mësimitdhënës dhe mekanizmin e vlerësimit të performancës së secilit prej tyre, si dy elemente përcaktuese. Avancimi në skemën e licencimit, ishte menduar të ndërli dhej me rritjen e pagës për mësimitdhënësit si instrument motivues i performancës së mirë. Përkundër këtyre planifikimeve, rezulton se në këtë fushë, si sfida mbetet moszbatimi i plotë i sistemit të licencimit të mësimitdhënësve, në të cilin:

1. Vlerësimi i bazuar në performancë dhe licencimi ende mungojnë;
2. Ekziston ofertë e kufizuar e zhvillimit të obliguar profesional të mësimitdhënësve;
3. Ka mungesë të strategjisë për zbatimin e vlerësimit të bazuar në performancë;
4. Ka mungesë të qasjes koherente në sistemin e zhvillimit të mësimitdhënësve, duke përfshirë koherencën midis zhvillimit para-shërbimit, fillimit të karrierës dhe zhvillimit në karrierë (MASHT, 2016).

1.2 Zhvillimi Profesional i Mësimitdhënësve

Me qëllim të përmbushjes së nevojave arsimore të një shoqërie moderne, kërkohet mësimitdhënie dhe nxënie e një cilësie të lartë. Që të arrihet kjo, mësimitdhënësit duhet të kenë njohuri dhe

shkathësi në lidhje me këto praktika (Solheim, 2017). Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit kërkon trajnime të vazhdueshme, ndërsa ajo çka u ofrohet sot mësimdhënësve për tu zhvilluar në aspektin e tyre profesional, është e pakët dhe e herë pas hershme (Demonte, 2013). Në kontekstin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve, sipas profesorit të Universitetit të Harvard-it, Hill (2009), “sistemi i zhvillimit profesional për mësimdhënësit, sipas të gjitha të dhënave, është i shkatërruar”. Pavarësisht kësaj, ekzistojnë hulumtime të cilat sugjerojnë dizajn apo modele të të mësuarit profesional që ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënit. Për tu arritur ky përmirësim, nevojitet mbështetje e trajnimeve të mësimdhënësve (Demonte, 2013). Në anën tjetër, në sistemin arsimor të Kosovës, përpos trajnimeve që variojnë nga shkolla në shkollë, edhe niveli i përgatitjes arsimore të mësimdhënësve në arsimin parauniversitar, është i ndryshëm prej atyre me përgatitje të mesme shkollore (përgatitja shkollore-normale), deri tek ata me përgatitje superiore dhe grada akademike.

4.2 ZHPM – Kualifikimet e mësimdhënësve




Figura 1. Kualifikimet e mësimdhënësve

(MASHT, 2019)

1.3 Sfidat e Reformës në Arsim

Sipas një studimi me fokus në periudhën 1999-2014, reformat e arsimit në Kosovë, të nxitura nga aktorë ndërkombëtarë⁴ të cilët përbëjnë politikë gjithëpërfshirëse multi-etnike, ishin në kundërshtim me vizionet e aktorëve vendorë të cilët i takonin një vendi të rezistencës kombëtare,

⁴Persona me ndikim në marrëdhëniet ndërkombëtare.

dhe se pa dashje kontribuuan në ndarjen e mëtejshme të arsimit përgjatë vijave etnike (Selenica, 2018). Një ndër sfidat që është evidentuar gjatë zbatimit të programeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve, ishte mosfunksionalizimi i plotë i sistemit të licencimit i cili ka rezultuar me demotivim të mësimdhënësve për vijimin e trajnimeve (Boshtrakaj, Rraci & Bajrami, 2018). Në anën tjetër, rreth 23,2% e mësimdhënësve kishin marrë pjesë në aktivitete të zhvillimit profesional, që tregon se trendi i përfshirjes së mësimdhënësve në aktivitete trajnime gjatë shërbimit ishte në rënie, ndërsa orët e kaluara në zhvillim profesional (mesatarisht 23 orë), ishin ende larg mesatares së vendeve të OECD⁵. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve është thelbësor dhe garantues i suksesit për arritshmëri të nxënësve, ndërsa buxheti i dedikuar për zhvillimin profesional të mësimdhënësve është i pamjaftueshëm, dhe se shkalla e pjesëmarrjes së komunës ende vazhdon të jetë e parëndësishme në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme. Në anën tjetër, në mungesë të udhëzuesve, ka pasur dhe vazhdon të ketë sfida të shumta që lidhen me planifikimin dhe udhëheqjen e procesit të zbatimit të Kurrikulës, gjë që rezultoi me rishikimin e KKK⁶-së në vitin 2016 (Boshtrakaj e të tjerë., 2018).

1.4 Reformat në Arsim dhe Rezistenca për Ndryshime

Mësimdhënësit me përvojë janë të vetëdijshëm që mësimdhënia dhe të nxënësve janë procese të ndërlikuara me shumë shtresa, por shumë shpesh diskutimet mbi politikën e mësimdhënies janë reduktuar në analiza të të dhënave të testit të përgjithshëm, në vend që të hapen diskutime rreth mënyrës së bartjes së njohurive praktike nga klasa në klasë (Lieberman, Désirée & Mace, 2008). Zhvillimi profesional i mësimdhënësve është një ndër komponentët kryesorë në pothuajse çdo propozim bashkëkohor për përmirësimin e cilësisë së arsimit. Hartuesit e politikave arsimore janë të vetëdijshëm se shkollat nuk mund të jenë më të mira se mësimdhënësit dhe administratorët që punojnë brenda tyre. Në anën tjetër, programet e zhvillimit profesional janë përpjekje sistematike për të sjellë ndryshime në praktikën që zhvillojnë mësimdhënësit në klasë, në qëndrimet dhe besimet e tyre, dhe në rezultatet e të nxënësve (Guskey, 2002). Ngjashëm sikurse në fushat tjera, edhe reformat në arsim shpesh përballen edhe me rezistencën për ndryshime, sidomos nga mësimdhënës dhe menaxherë të papërgatitur për ndryshime. E tërë kjo ndodh edhe për arsye se tranzicioni përfshin largimin nga mënyra se si kanë qenë gjërat, hyrja në një zonë neutrale duke

⁵Organization for Economic Cooperation and Development (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik).

⁶ KKK- Korniza e Kurrikulës së Kosovës

devijuar nga mënyra e vjetër, por akoma e pa zbatuar mënyra e re dhe, duke adoptuar një fillim të ri (Brody & Hadar, 2017). Shkollat kanë strukturuar gjithnjë e më shumë mësimin si një përpjekje bashkëpunuese me komunitetin, gjithsesi bashkëpunimi i mësimdhënësve është një tipar i rëndësishëm i zhvillimit profesional. Bashkëpunimi mund të përfshijë një mori konfiguracionesh, duke filluar nga bashkëveprimet e mësimdhënësve me njëri tjetrin ose një grupi të vogël me të gjithë shkollën, në mënyrë që të adresohen sfidat apo problemet të profesionistët e tjerë përtej shkollës (Hammond, Hylar, Gardner & Espinoza, 2017). Përmirësimet e nevojshme në cilësinë e arsimit, veçanërisht në arritjet e studentëve, kërkojnë zbatim efektiv të kurrikulave bazuar në kompetenca (Makunja, 2016). Bazuar në standarde si dhe organe profesionale për mësimdhënës të cilat janë duke u krijuar, zhvillimi profesional dhe trajnimet janë duke pësuar ndryshime (Goodson & Hargreaves, 2003).

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në mënyrë që hulumtimi të arrijë qëllimin e tij, është përdorur metoda sasiore e hulumtimit, përmes së cilës janë mbledhur të dhëna të nevojshme për të pasqyruar zbatimin e Kurrikulës së Re në katër shkolla fillore të qytetit të Vushtrrisë. Metodatat sasiore kërkimore përdoren për të kërkuar të dhëna kuantitative që përfshijnë shpjegime numerike dhe statistikore (Ross & Bob, 2010). Gjatë hulumtimit janë parashtruar pyetje të tilla: Si?, Çfarë?, Cilat?, A mendoni?, A jeni të kënaqur? etj.

2.1 Hipotezat

Në vitet e fundit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka promovuar reformimin e sistemit arsimor në Kosovë, duke vënë në zbatim Kurrikulën e Re për shkollat fillore të Kosovës që përfshijnë klasat 1-5. Zbatimi i Kurrikulës së Re duket se nuk do të jetë pjesë e lehtë për Ministrinë e Arsimit, drejtoritë komunale të arsimit, drejtorët e shkollave, dhe në veçanti për mësuesit e shkollave fillore, të cilët janë duke u përballur me sfidat e zbatimit të kësaj kurrikule e cila ngërthen në vete futjen e metodave të reja të mësimit. Të gjitha këto vështirësi duket të jenë pasojë e përgatitjeve të pamjaftueshme të institucioneve arsimore, e në veçanti të mësuesve si zbatues praktikë të metodave që dalin nga Kurrikula e Re. Përshtatja e plan-programit me parimet e të mësuarit të shekullit XXI, nuk paraqet një detyrë të lehtë por kërkon angazhim të përbashkët të hartuesve të kurrikulës, agjencive qeveritare të arsimit, drejtuesve të shkollave dhe mësuesve, me qëllim të përfshirjes së këtyre parimeve në çdo program mësimor (Barrot, 2018.) Në anën tjetër, Raporti Vjetor i Progresit 2018 i Komisionit Evropian për Kosovën, tregon mungesë të cilësisë së arsimit, pasi rekomandimet e raportit të mëparshëm nuk ishin adresuar (European Commission, 2018). Gjetjet e raporteve të mëparshme për funksionimin e arsimit në Kosovë, si dhe rezultatet e Testit PISA, na japin një pasqyrë të qartë dhe lehtësojnë studimin tonë për të analizuar në thellësi zhvillimin profesional të mësuesve, si dhe vështirësitë në zbatimin e Kurrikulës së Re në shkollat fillore të qytetit të Vushtrrisë, duke u bazuar në hipotezat kryesore të përcaktuara për këtë hulumtim si:

1. Trajnimet e ndjekura nga mësime të ndërhënësve janë të pamjaftueshme për zbatimin e KKK-së.
2. Bashkëpunimi ndër-kolegjal ndikon në përvetësimin e metodave për zbatimin e Kurrikulës.

2.2 Pjesëmarrësit

Me qëllim që hulumtimi të ofrojë rezultate, është përzgjedhur popullata e mësime të ndërhënësve të arsimit fillor në katër shkollat e qytetit të Vushtrisë; “ Ali Kelmendi”, “Andon Zako Çajupi”, “Mustaf Venhari”, dhe “Naim Frashëri”. Përmes mostrës së qëllimshme, nga 52 mësime të ndërhënësve të klasave 1-5 të këtyre shkollave, në hulumtim janë përfshirë gjithsej 41. Karakteristikë specifike e përfshirjes së këtyre mësime të ndërhënësve në hulumtim, është përfundimi i trajnimit për zbatimin e Kurrikulës së Re.

Tabela 1
Të Dhënat Përshkruese për Gjininë e Pjesëmarrësve

Gjinia	Frekuenca	Përqindja
Femër	32	78.0
Mashkull	9	22.0
Totali	41	100.0

Bazuar në tabelën 1, nga 41 (100.0%) pjesëmarrës në hulumtim, 32 (78.0%) ishin femra dhe 9 (22.0%) ishin meshkuj, gjë që tregon një numër më të madh të femrave të përfshira në mësime të ndërhënësve.

Tabela 2

Të Dhënat Përshkruese për Nivelin e Arsimimit të Mësimdhënësve

Niveli i arsimimit	Frekuenca	Përqindja
Shkolla normale	2	4.9
Bachelor	22	53.7
Bachelor përmes AKM	14	34.1
Master	3	7.3
Totali	41	100.0

Sa i përket nivelit të arsimimit të mësimdhënësve pjesëmarrës në hulumtim, dy (4.9%) nga ta kishin përfunduar shkollën normale, 22 (53.7%) Bachelor-in, 14 (34.1%) Bachelor nga SHLP-avancim përmes programit AKM, si dhe tre (7.3%) Master-in. Nga tabela vërejmë qartë se pjesa më e madhe e mësimdhënësve kishin përfunduar studimet Bachelor.

2.3 Instrumentet

Në mënyrë që të dhënat të jenë të besueshme dhe ky hulumtim të arrijë qëllimin e tij, si instrumente matëse kërkimore kemi përdorur pyetësin e pilotuar, të hartuar nga vetë hulumtuesi i këtij punimi. Pyetësi i është përshtatur hulumtimit sipas hipotezave të parashtruara.

2.4 Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Që mësimdhënësit të jenë pjesë e këtij hulumtimi, është marrë leje nga drejtorët e këtyre shkollave si dhe është paraqitur dhe sqaruar qëllimi i hulumtimit, e më pas janë shpërndarë te secili nga drejtorët një numër i caktuar i pyetësorëve (varësisht nga numri i mësimdhënësve të trajnuar). Pothuajse çdo ditë është mbajtur korrespondencë me drejtorët e shkollave lidhur me ecurinë e mbledhjes së të dhënave nga mësimdhënësit, që nga data 10 maj. Nga 60 pyetësorë që ishin shpërndarë në katër shkolla fillore të qytetit të Vushtrrisë brenda datave 10.05-24.05.2019, gjithsej 41 pyetësorë ishin të plotësuar me të dhëna.

2.5 Analiza e të dhënave

Për analizimin dhe llogaritjen e të dhënave është përdorur programi SPSS, ku janë kryer dy lloje analizash të nevojshme për hulumtim, analiza e marrëdhënieve në mes ndryshoreve përmes Krostabulimit (Crosstabulation) si dhe analizës përshkruese, Frekuencës (Frequency). Rezultatet janë paraqitur në formë tabelare, ndërsa interpretimi i tyre është bërë duke paraqitur të dhënat më konsistente, të lidhura me kornizën teorike të përdorur në studimin kërkimor, duke integruar teorinë në gjetjet tona dhe duke rishikuar literaturën. Gjetjet janë analizuar dhe krahasuar me studimet e mëparshme.

2.6 Aspekti etik

Me qëllim që ky hulumtim tu përmbahet rregullave akademike si dhe parimit etik, kemi siguruar cilësinë e hulumtimit duke u bazuar veçanërisht në etikën e hulumtimit, si njëra ndër parimet bazë të një studimi i cili kërkon saktësi, përgjegjësi dhe kompetencë. Si rregull thelbësore ishte informimi i stafit të shkollave fillore të qytetit të Vushtrrisë rreth qëllimit të hulumtimit dhe metodës së tij. Duke marrë parasysh që ky hulumtim është bërë në katër shkollat fillore të qytetit të Vushtrrisë, në të cilin janë përfshirë 41 mësimdhënës të klasave 1-5 të trajnuar për zbatimin e Kurrikulës së Re, ne u kujdesëm në veçanti që ta mbajmë anonimitetin e secilit pjesëmarrës në këtë hulumtim. Lidhur me këtë, kemi informuar secilin nga respondentët para plotësimit të pyetësorit rreth përmbajtjes së tij, me qëllim që të merren informacione të vlefshme dhe të besueshme.

3. REZULTATET

3.1 Zbatimi i Kurrikulës së Re

Lidhur me rezultatet e dala nga pyetësi, janë përdorur gjithsej 21 pyetje për të matur perceptimet e mësimeve rreth zbatimit të Kurrikulës së Re në katër shkollat e qytetit të Vushtrrisë. Respondentët e këtij hulumtimi u pyetën nëse mendojnë se shtatë fushat e përcaktuara në Kurrikulën e Re i përfshijnë mjaftueshëm lëndët mësimore, nëse planet vjetore, dymujore dhe javore hartohen në bashkëpunim me aktivin etj. Nga respondentët u kërkua që të vlerësonin përmes shkallës së Liker-it, përveç në disa raste ku janë përdorur opsione të tjera të përgjigjeve.

Duke iu referuar tabelës 3, nga 41 mësimeve sa ishin pjesëmarrës në hulumtim, të cilët u pyetën nëse mendonin se Kurrikula e Re është e përshtatshme për zbatim, shumica e tyre vlerësuan pozitivisht përshtatjen e KKK-së për zbatim. Ndërsa, në pyetjen hulumtuese se “a mendoni se kompetencat e të nxënësve të përcaktuara në Kurrikulën e Re janë të arritshme nga nxënësit”, pjesa më e madhe e mësimeve u përgjigjën po ashtu pozitivisht. Në anën tjetër, një pjesë e madhe e mësimeve treguan se rezultatet e të nxënësve për kompetenca kryesore të shkallës I janë të arritshme nga nxënësit.

Tabela 3.

Rezultatet e Hulimit për Gjini, Nivel Arsimimi dhe Moshë, lidhur me Përshtatshmërinë e KKK-së, Kompetencat e të Nxënës, si dhe Arritshmëria e Kompetencave për Shkallë I

			Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Nuk e di	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	
V1. A mendoni që Kurrikula e Re është e përshtatshme për zbatim?	D1. Gjinia:	Mashkull	0.0%	11.1%	11.1%	44.4%	33.3%	
		Femër	6.3%	3.1%	9.4%	65.6%	15.6%	
	D2. Niveli i arsimimit që e keni përfunduar:	Shkolla normale				100.0%		
		Bachelor	9.1%	4.5%	9.1%	59.1%	18.2%	
		Bachelor nga AKM	0.0%	7.1%	14.3%	57.1%	21.4%	
		Master	0.0%	0.0%	0.0%	66.7%	33.3%	
	Mosha:	>50	5.7%	2.9%	8.6%	62.9%	20.0%	
		<50		16.7%	16.7%	50.0%	16.7%	
	V2. A mendoni se kompetencat e të nxënës të përcaktuara në Kurrikulën e Re janë të arritshme nga nxënësit.	D1. Gjinia:	Mashkull	0.0%	0.0%	11.1%	88.9%	
			Femër	12.5%	0.0%	6.3%	59.4%	21.9%
D2. Niveli i arsimimit që e keni përfunduar:		Shkolla normale	0.0%	0.0%	50.0%	50.0%		
		Bachelor	18.2%	0.0%	4.5%	59.1%	18.2%	
		Bachelor nga AKM	0.0%	0.0%	7.1%	71.4%	21.4%	
		Master	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	0.0%	
Mosha:		>50	8.6%	0.0%	5.7%	68.6%	17.1%	
		<50	16.7%	0.0%	16.7%	50.0%	16.7%	
V3. A mendoni se rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës I janë të arritshme nga nxënësit?		D1. Gjinia:	Mashkull	11.1%	0.0%	0.0%	55.6%	33.3%
			Femër		9.4%	15.6%	56.3%	18.8%
	D2. Niveli i arsimimit që e keni përfunduar:	Shkolla normale	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	0.0%	
		Bachelor	4.5%	13.6%	13.6%	45.5%	22.7%	
		Bachelor nga AKM	0.0%	0.0%	14.3%	57.1%	28.6%	
		Master	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	0.0%	
	Mosha:	>50	2.9%	5.7%	14.3%	54.3%	22.9%	
		<50	0.0%	16.7%	0.0%	66.7%	16.7%	

Në lidhje me rezultatet nga tabela 4, shohim qartë një qëndrim pozitiv të mësimeve me arritjen e kompetencave kryesore të shkollës II të nxënësve, si dhe për përfshirjen e lëndëve mësimore në shtatë fushat e përcaktuara në Kurrikulën e Re. Kurse sa i përket planifikimit të orëve mësimore në bazë të planeve vjetore, mësuesit treguan se ata ishin gjithëherë planifikues të rregullt të këtyre orëve.

Tabela 4

Rezultatet e Hulimit për Gjini, Nivel Arsimimi dhe Moshë, lidhur me Arritshmërinë e Kompetencave për Shkallë II, Përfshirjen e Lëndëve në Fushat Kurrikulare, si dhe Harmonizimin e Planeve Ditore dhe Vjetore

			Nuk pajtohem		Pajtohem		Pajtohem plotësisht		
			aspak	Nuk pajtohem	Nuk e di	Pajtohem			
V4. A mendoni se rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës II janë të arritshme nga nxënësit?	D1. Gjinia:	Mashkull	11.1%	0.0%	0.0%	55.6%	33.3%		
		Femër	0.0%	6.3%	18.8%	62.5%	12.5%		
	D2. Niveli i arsimimit që e keni përfunduar:	Shkolla normale	0.0%	0.0%	50.0%	50.0%	0.0%		
		Bachelor	4.5%	9.1%	9.1%	68.2%	9.1%		
		Bachelor nga AKM	0.0%	0.0%	14.3%	50.0%	35.7%		
		Master	0.0%	0.0%	33.3%	66.7%	0.0%		
		>50	2.9%	2.9%	14.3%	62.9%	17.1%		
		<50	0.0%	16.7%	16.7%	50.0%	16.7%		
	V5. A mendoni se shtatë fushat e përcaktuara në Kurrikulën e Re i përfshijnë mjaftueshëm lëndët mësimore?	D1. Gjinia:	Mashkull	0.0%	0.0%	0.0%	55.6%	44.4%	
			Femër	0.0%	12.5%	6.3%	28.1%	53.1%	
D2. Niveli i arsimimit që e keni përfunduar:		Shkolla normale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%		
		Bachelor	0.0%	13.6%	4.5%	40.9%	40.9%		
		Bachelor nga AKM	0.0%	7.1%	0.0%	21.4%	71.4%		
		Master	0.0%	0.0%	33.3%	66.7%	0.0%		
		>50	0.0%	8.6%	2.9%	34.3%	54.3%		
		<50	0.0%	16.7%	16.7%	33.3%	33.3%		
V6. Panifikimet ditore janë ne harmoni me planet vjetore?		D1. Gjinia:	Mashkull	0.0%	0.0%	0.0%	33.3%	66.7%	
			Femër	0.0%	6.3%	3.1%	37.5%	53.1%	
	D2. Niveli i arsimimit që e keni përfunduar:	Shkolla normale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%		
		Bachelor	0.0%	4.5%	4.5%	45.5%	45.5%		
		Bachelor nga AKM	0.0%	7.1%	0.0%	21.4%	71.4%		
		Master	0.0%	0.0%	0.0%	66.7%	33.3%		
		>50	0.0%	5.7%	2.9%	34.3%	57.1%		
		<50	0.0%	0.0%	0.0%	50.0%	50.0%		

Përveç planifikimit të orëve mësimore në bazë të planeve vjetore, në tabelën e mëposhtme shihet qartë se mësimdhënësit ndërlidhin planifikimet e tyre me planet dymujore. Sa i përket ndryshimeve kurrikulare, mësimdhënësit tashmë i njoftonin nxënësit e tyre rreth këtyre ndryshimeve.

Si pjesë e aktiviteteve në bazë të kurrikulës janë edhe projektet e punuara nga nxënësit e që më pas duhet të prezantohen nga vetë ata. Të pyetur nëse nxënësit udhëzohen të punojnë diçka të tillë, pjesa më e madhe e mësimdhënësve u përgjigjën pozitivisht rreth angazhimit të nxënësve me projekte.

Tabela 5

Rezultatet e Hulimit për Gjini, Nivel Arsimimi dhe Moshë, lidhur me Harmonizimin e Planeve Ditore me Dymujore, Informimin e Nxënësve me Ndryshimet Kurrikulare si dhe Prezantimin e Projekteve të Nxënësve

			Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Nuk e di	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	
V7. Planifikimet ditore janë në harmoni dymujore.	D1. Gjinia:	Mashkull	0.0%	0.0%	0.0%	33.3%	66.7%	
		Femër	0.0%	6.3%	0.0%	34.4%	59.4%	
	D2. Niveli i arsimimit që e keni përfunduar:	Shkolla normale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	
		Bachelor	0.0%	4.5%	0.0%	36.4%	59.1%	
	Moshë:	Bachelor nga AKM	0.0%	7.1%	0.0%	28.6%	64.3%	
		Master	0.0%	0.0%	0.0%	66.7%	33.3%	
	Moshë:	>50	0.0%	5.7%	0.0%	31.4%	62.9%	
		<50	0.0%	0.0%	0.0%	50.0%	50.0%	
	V8. Nxënësit janë të informuar për ndryshimet kurrikulare.	D1. Gjinia:	Mashkull	0.0%	0.0%	11.1%	44.4%	44.4%
			Femër	3.1%	3.1%	6.3%	43.8%	43.8%
D2. Niveli i arsimimit që e keni përfunduar:		Shkolla normale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	
		Bachelor	0.0%	4.5%	13.6%	40.9%	40.9%	
Moshë:		Bachelor nga AKM	7.1%	0.0%	0.0%	42.9%	50.0%	
		Master	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	0.0%	
Moshë:		>50	2.9%	0.0%	8.6%	42.9%	45.7%	
		<50	0.0%	16.7%	0.0%	50.0%	33.3%	
V9. Nxënësit bëjnë projekte të ndryshme dhe më pas i prezantojnë ato.		D1. Gjinia:	Mashkull	0.0%	11.1%	0.0%	77.8%	11.1%
			Femër	0.0%	18.8%	6.3%	56.3%	18.8%
	D2. Niveli i arsimimit që e keni përfunduar:	Shkolla normale	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	0.0%	
		Bachelor	0.0%	13.6%	4.5%	63.6%	18.2%	
	Moshë:	Bachelor nga AKM	0.0%	28.6%	0.0%	50.0%	21.4%	
		Master	0.0%	0.0%	33.3%	66.7%	0.0%	
	Moshë:	>50	0.0%	20.0%	5.7%	54.3%	20.0%	
		<50	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	0.0%	

Bazuar në tabelën e mëposhtme, në të cilën mësimitdhënësit u pyetën rreth informimit të nxënësve me kriteret, format dhe periudhat e vlerësimit, informim i cili është i domosdoshëm nga ana e mësimitdhënësve, ata deklaruan se pjesa më e madhe e nxënësve rregullisht njoftohen me këtë proces vlerësimi.

Tabela 6

Rezultatet e Hulumentimit për Gjini, Nivel Arsimimi dhe Moshë, lidhur me Informimin e Nxënësve me Kriteret, Format dhe Periudhat e Vlerësimit

			Nuk pajtohem		Pajtohem			
			aspak	Nuk pajtohem	Nuk e di	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	
V10. Nxënësit janë të informuar për kriteret e vlerësimit.	D1. Gjinia:	Mashkull	0.0%	0.0%	11.1%	33.3%	55.6%	
		Femër	0.0%	9.4%	3.1%	43.8%	43.8%	
	D2. Niveli i arsimimit që e keni përfunduar:	Shkolla normale	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%	
		Bachelor	0.0%	4.5%	9.1%	45.5%	40.9%	
		Bachelor nga AKM	0.0%	14.3%	0.0%	35.7%	50.0%	
	Mosha:	Master	0.0%	0.0%	0.0%	66.7%	33.3%	
		>50	0.0%	8.6%	5.7%	40.0%	45.7%	
		<50	0.0%	0.0%	0.0%	50.0%	50.0%	
		Mashkull	0.0%	0.0%	0.0%	55.6%	44.4%	
	V11. Nxënësit janë të informuar për format e vlerësimit.	D1. Gjinia:	Femër	0.0%	3.1%	3.1%	46.9%	46.9%
Shkolla normale			0.0%	0.0%	0.0%	50.0%	50.0%	
D2. Niveli i arsimimit që e keni përfunduar:		Bachelor	0.0%	4.5%	4.5%	50.0%	40.9%	
		Bachelor nga AKM	0.0%	0.0%	0.0%	42.9%	57.1%	
		Master	0.0%	0.0%	0.0%	66.7%	33.3%	
Mosha:		>50	0.0%	2.9%	2.9%	42.9%	51.4%	
		<50	0.0%	0.0%	0.0%	83.3%	16.7%	
V12. Nxënësit janë të informuar për periudhat e vlerësimit.		D1. Gjinia:	Mashkull	0.0%	0.0%	0.0%	55.6%	44.4%
			Femër	0.0%	3.1%	3.1%	34.4%	59.4%
